

TITULLI I PROJEKTIT

Rritja e konektivitetit në Brezin e Gjelbër të Ballkanit in Shqipëri, Maqedonia e Veriut



Pamje e maleve në Shebenik-
Jabllanicë

Burimi: Xhemal Xherri

Begraundi

Brezi i Gjelbër Ballkanik (BGB) është thelbësor për zhvillimin e Infrastruktursë së Gjelbër (GI) në nivel Evropian. Megjithatë, intensifikimi i përdorimit të tokës dhe zhvillimi i infrastrukturës ka ushtruar presion mbi habitatet përgjatë Brezit të Gjelbër të Ballkanit dhe konektivitetit të tij. Planifikimi i territorit dhe i përdorimit të tokës janë mjete të rëndësishme për të balancuar përdorime të ndryshme të tokës dhe interesat të ndryshme. Përveç kësaj, planifikimi i territorit mundëson zbatimin dhe ruajtjen afatgjatë të Infrastruktursë së Gjelbër. Megjithatë, koncepti i Infrastruktursë së Gjelbër ka qenë kryesisht i panjohur për vendimmarrësit përgjegjës për vendimet e planifikimit të peizazhit në rajon.

Projekti

Objektivi kryesor i projektit është të zhvillojë dhe sigurojë Brezin e Gjelbër të Ballkanit (BGB) dhe lidhjen së tij si pjesë e Infrastruktursë së Gjelbër përtej zonave të mbrojtura. Për këtë është i nevojshëm përmirësimi i legjislacionit dhe zbatimi i planifikimit të përdorimit të tokës përgjatë tij, me fokus Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Bazuar në kuadrin e dhënë nga BE, ekipi i projektit identifikon boshllëqet dhe nevojat për përshtatjen e kuadrit ligjor kombëtar. Bazuar në këtë nxiren rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor kombëtar përkatës dhe zbatimin e tij. Trajnimet mbështesin rritjen e kapaciteteve në ministrinë përkatëse, autoritetet në varësine e tyre dhe në rajonin pilot ndërkufitar Shebenik-Jabllanicë. Grupet drejtuese kombëtare të projektit sigurojnë koordinim teknik me vendimmarrësit e të dy vendeve.

Në rajonin pilot Shebenik-Jabllanicë projekti përpunon rekomandime për përmirësimin e proceseve konkrete të planifikimit në nivel Bashkie. Shkëmbimi intensiv i informacionit ndërmjet departamenteve përgjegjëse për planifikimin territorial përgatit harmonizimin e procedurave kombëtare në rajonin pilot.

Updated: December 2021

Rajoni: Shqipëri, Maqedonia e Veriut

Kohëzgjatja: 12/2021 – 11/2023

Grupi i synuar për këshillim: Ministrinë dhe autoritetet në varësi, agjencitë, bashkitë, shoqëria civile, organizatat jo qeveritare

Organizatat implementuese: EuroNatur (Gjermani), Shoqata Ekologjike Maqedonase (Maqedonia e Veriut), Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (Shqipëri)

Numri i projektit: 168250

Menaxhimi tematik:

Agjencia Federale për Ruajtjen e Natyrës (BfN)

Dr. Karin Ullrich

Tel.: +49-228 84 91-1522

karin.ullrich@bfn.de

Koordinimi i projektit:

Njësia e shërbimit të Projektit AAP

Dr. Sonja Otto

Tel.: +49-340-2103-2210

sonja.otto@uba.de

Advisory Assistance Programme (AAP)

for environmental protection in the countries of Central and Eastern Europe, the Caucasus and Central Asia and other countries neighbouring the European Union – a programme of the Federal Ministry for Environment, Nature Conservation, Nuclear Safety and Consumer Protection

AAP Project service unit:

AAP-info@uba.de

www.uba.de/en/project-database-advisory-assistance-programme
www.uba.de/en/advisory-assistance-programme